L I G J
Nr.9593, datë 27.7.2006

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8950, DATË 10.10.2002 "PËR GJENDJEN CIVILE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikat 1 e 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 3 të nenit 2 shtohen pikat 3/a e 3/b me këtë përmbajtje:

"3/a. Vendbanim është njësia e qeverisjes vendore, ku shtetasi ka banesën e vet për një periudhë më të gjatë se një vit.

3/b. Vendqëndrim është njësia e qeverisjes vendore, ku shtetasi ka banesën e vet për një periudhë më shumë se 45 ditë dhe më pak se një vit.".

Neni 2

Në pikën 1 të nenit 8 "Përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile të shtetasve", pas fjalës "vendbanim" shtohet fjala "vendqëndrim".

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 11 fjala "të përhershëm" dhe fjalia e dytë hiqen.

Neni 4

Në nenin 12 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet dhe bëhet "Transferimi, bashkimi familjar dhe deklarimi i vendqëndrimit".

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

"4/l. Shtetasit, që qëndrojnë në një njësi vendore për më shumë se 45 ditë dhe më pak se një vit, janë të detyruar të deklarojnë pranë zyrës së gjendjes civile vendqëndrimin e tyre. Shtetasit nuk mund të deklarojnë dhe të kenë njëherazi më shumë se një vendqëndrim. Deklarimi regjistrohet në zyrën e gjendjes civile të vendqëndrimit. Zyra e gjendjes civile të vendqëndrimit të shtetasit njofton zyrën e gjendjes civile të vendbanimit, e cila bën shënimin përkatës.".

3. Në pikën 5 shtohen fjalët "ose të deklarojë vendqëndrimin jo më vonë se 45 ditë nga ardhja në vendqëndrimin e tij.".

4. Në pikën 7, pas fjalëve "të dhënave të gjendjes civile" shtohen fjalët "dhe deklarimin e vendqëndrimit".

Neni 5

Pas shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 19 shtohen shkronjat "a/1" e "a/2" me këtë përmbajtje:

"a/1. Regjistri Themeltar i Gjendjes Civile, me vendbanim.

a/2. Regjistri Themeltar i Gjendjes Civile, me vendqëndrim.".

Neni 6

Në fund të pikës 1 të nenit 21 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Në varësi nga natyra e vendbanimit apo vendqëndrimit të shtetasve, zyra e gjendjes civile mban:
Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile, me vendbanim;
Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile, me vendqëndrim.".

Neni 7

Pas pikës 1 të nenit 24 shtohet pika 1/a me këtë përmbajtje:
"1/a. Për krijimin e regjistrave themeltarë të gjendjes civile, me vendqëndrim, përdoren të dhënat e përditësuara, që përmbajnë regjistrat e përkohshëm të shtetasve, të krijuara në zbatim të ligjit nr.9296, datë 21.10.2004 "Për verifikimin, identifikimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore" dhe të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.".

Neni 8

Kudo në ligj emërtimi "Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit" zëvendësohet me emërtimin "Ministria e Brendshme".

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5013, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu